



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA TEPELENE
DREJTORIA E ARSIM KULTURES DHE KUJDESIT SOCIAL

Nr 20 Prot

Tepelene me 20 / 02 / 2025

LËNDA: Informacion

DREJTUAR : Keshillit Bashkiak

Tepelene

Te Nderuar Keshilltare ,

Drejtoria e Arsim Kultures dhe Kujdesit Social mbështet aktivitetin e saj në zbatim të Ligjit 139/2015 “Per Vetqeverisjen Vendore”, ligjit 69/2012 “Per Arsimin Parauniversitar” i ndryshuar , si dhe Rregullores së Brendshme për Organizimin , Funksionimin, Detyrat dhe Kopetencat e Njesisë Vendore të Bashkisë Tepelene .

Drejtoria e Arsim Kultures dhe Kujdesit Social është përgjegjëse për administrimin në terren të të gjitha shërbimeve që lidhen me arsimin parashkollor (administrim çerdhe, kopshte) arsimin parauniversitar (mirembajtje te institucioneve arsimore)

Sistemi arsimor ka rëndësi të madhe në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe social të komunitetit tonë.

Shkolla duhet t’i mundësojë çdo fëmije që të ketë rezultate të kënaqshme në mësim, të jetë i sigurtë, i shëndetshëm dhe aktiv në jetën komunitare.

Me ndarjen e re territoriale, Bashkia Tepelenë duhet të sigurojë mirëmbajtjen e një numri të madh institucionesh arsimore që kryejnë funksionin pranë bashkisë sonë prej 22 shkolla të arsimit parauniversitar dhe 1 shkollë e mesme, që kërkojnë një vëmendje të veçantë.

1. Gadishmëria e godinave shkollore

- Është kryer verifikimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës në të gjitha shkollat e Arsimit Parauniversitar në juridiksion të Bashkisë Tepelenë për furnizimin me drita, ujë, ngrohje dhe tualete funksionale .
- Janë marrë masat për ndërhyrjet e planifikuara që do të kryhen dhe do të jenë gati para nisjes se vitit të ri shkollor .
- Janë marrë masat për sigurimin e kushteve higjeno-sanitare sipas standarteve në të gjitha institucionet Arsimore . Gjithashtu Institucionet arsimore jane pajisur me akt-miratim

higjeno –sanitar dhe me Çertifikate DDD (Dezinfektim, dezinfektim dhe deratizimin e ambjenteve të brendshme dhe të jashtme të institucioneve arsimore).

2. Mjediset rreth shkollave

- Eshte kryer rrethimi i disa prej shkollave te Njesive Administrative.
- Ne te gjitha Institucionet Arsimore po vazhdon rregullimi i ambjenteve te jashtme .
- Të gjitha shkollat janë të pajisura me sinjalistikë rrugore pranë tyre .
- Te gjitha institucionet arsimore te qytetit Tepelene jane te pajisura me kamera sigurie .

3. Transporti i nxënësve

Këshilli Bashkiak Tepelenë ka miratuar në buxhetin Bashkisë Tepelenë nismën për mbështetjen e transportit të nxënësve të zonave të largëta që ndjekin Arsimin e Mesëm pranë Gjimnazit “Abaz Shehu” Tepelenë .

4. Mbështetja për shkollat

Sigurimi i bashkëpunimit në vijimësi me Zyrat Vendore të Arsimit dhe drejtoritë e institucioneve arsimore parauniversitare për zgjidhjen e problematikave dhe plotësimin e çdo nevojë është jo vetëm në fillim të viti të ri shkollor , por dhe gjatë vitit shkollor.

Synimi ynë është menaxhimi me efikasitet i fondeve për arsimin dhe krijimi i mundësive për një zhvillim e shfrytëzim cilësor të infrastrukturës së institucioneve arsimore në të gjithë territorin e Bashkisë Tepelenë.

Per ket vit shkollor Bashkia Tepelene ka marre masat per mirembajtje te institucioneve arsimore si me poshte

Sistemi Arsimor Parauniversitar :

- Në Bashkinë Tepelene funksionojnë :
- 1 shkollë e mesme në qytet
- 2 shkolla 9-vjeçare në qytet
- Dhe 21 shkolla 9- vjeçare në Njësitë Administrative Qender , Lopes dhe Kurvelesh

1- Ne Bashkinë Tepelenë qytet :

- Çerdhe Tepelene , Kopshti “Murat Koçi” Tepelene , janë kryer punime për rikonstruksion pjesor, lysterje dhe mirëmbajtje godine.
- Shkolla 9-vjeçare “Avni Rustemi” Tepelenë janë kryer punime lysterje e mirembajtje e zakonshme .
- Shkolla 9- vjeçare “7 Marsi” Tepelenë janë kryer punime per lysterje e mirembajtje godine.
- Shkolla të Mesme Arsimi i përgjithshëm 1 (një) . Shkolla e Mesme e Përgjithshme “Abaz Shehu” Tepelenë pati nderhyrje te brendshme kati I pare si dhe ne ambjentet e jashtme.
- Eshte kryer rrethimi i disa prej shkollave te Njesive Administrative.
- Ne te gjitha Institucionet Arsimore se bashku me drejtorine e sherbimeve Publike po vazhdon rregullimi i ambjenteve te jashtme .
Ne çerdhe , kopshte , shkolla te qytetit sistemi i ngrohjes fillon ne date 15 Nentor dhe ne kushte optimale per zhvillimin e procesit mesimor.

2- Në Njësinë Administrative Qender Tepelenë :

- Shkolla 9-vjeçare dhe Cikli i Ulet gjithsej 11 shkolla dhe kopshte 12 (dymbëdhjetë) , jane kryer rikonstrukcion pjesor (lyerje dhe mirëmbajtje godine) .

3- Në Njësinë Administrative Lopës Tepelenë :

Shkolla 9-vjeçare 3 (tre) dhe kopshte në varësi 2 (dy) , ka perfunduar rikonstrukcioni pjesor (lyerje + mirëmbajtje godine) .

4- Në Njësinë administrative Kurvelesh :

Shkolla 9-vjeçare 3 (tre) , kopshte 1 (nje) ka perfunduar rikonstrukcioni pjesor (lyerje + mirëmbajtje godine) .

- Kete vit i kemi kushtuar rendesi krijimit te kushteve sa me optimale per zhvillimin e mesimit dhe pajisjen e shkollave me kushtet higjeno – sanitare (drita – uje – tualete).
- Gjithashtu Institucionet arsimore jane pajisur me akt-miratim higjeno –sanitar dhe me Çertifikate DDD (Dezinfektim, dezinsektim dhe deratizimin e ambjenteve të brendshme dhe të jashtme të institucioneve arsimore).
- Eshte kryer rimbushja e mjete kunder zjarrit prane Institucioneve Arsimore (proces qe po kryhet cdo vit) si dhe eshte kryer kontrolli i analizes se ujit per te gjitha institucionet arsimore.
- Te gjitha institucionet arsimore te qytetit Tepelene jane te pajisura me kamera sigurie .
- Ashtu si vitin e kaluar dhe per kete vit Bashkia Tepelene ka vene ne funksion te zhvillimit te ores se fiskultures (Basketboll, pingpong, futboll) Qendren Multifunksionale te qytetit .

Arsimi parauniversitar dhe edukimi

- Arsimi Parashkollor dhe Parauniversitar ka kaluar pranë Bashkisë Tepelenë në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” ,Urdhërit të Kryeministrit nr 127 datë 16.09.2015 “Për marrjen e masave në kuadër dhe në funksion të zbatimit të strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore”.

Sistemi arsimor parashkollor kopshte: 1 kopesht ne qytet , dhe 15 kopshte ne Njesite Administrative Qender, Lopes dhe Kurvelesh.

Gjithsej shpenzime për Institucionet Arsimore per periudhen janar –shtator 2025 janë kryer nga Bashkia Tepelenë :

1	Blerje nafte per sherbimin e ngrohjes ne institucione shkollore	952000
2	Blerje dru zjarri per sherbimin e ngrohjes ne institucione shkollore	906000
3	Blerje kancelari	35,000
4	Blerje detergjente dhe materiale pastrimi	567 600
5	Dezifektimi i institucioneve shkollore	300000
6	Shpenzime energi elektrike	1,480,000

7	Lyerje Mirembajtje institucione shkollore	970 000
8	Shpenzime Uji	326,400
10	Total	

Për planifikimin e shpenzimeve janë marrë parasysh kërkesat ardhur nga Drejtoria e Pergjithshme e Arsimit Parauniversitar si dhe kërkesat e ardhura nga Institucionet Arsimore nën juridiksion të Bashkisë Tepelenë .

Per kete vit Bashkia ka realizuar synimet :

Krijimi i ambjenteve dhe mjediseve te sistemit arsimor , te sigurt konform standarteve ligjore dhe higjenikisht te sigurta .

Krijimi i sistemit të menaxhimit të informacionit në sektorin e arsimit parauniversitar dhe mbulimi i plotë i territorit me institucione të arsimit parauniversitar.

Sigurimi i shërbimeve mbështetëse, cilësore në të gjithë territorin, për institucionet e edukimit parauniversitar dhe atij parashkollor gjatë procesit të realizimit të programit mësimor vjetor.

Përmirësimi i sistemeve të edukimit dhe trajnimit profesional dhe ndërlidhja e politikës arsimore me politikën social-ekonomike.

Mbështetja dhe promovimi i cilësisë së mësimdhënies dhe i rezultateve të larta në shkollë. Çdo vit Bashkia vlereson nxenesit me rezultate te larta ne mesime .

Promovimi dhe nxitja e hapjes se strukturave të edukimit jashtë orarit mësimor, për të plotësuar një nga të drejtat bazë të fëmijëve, siç është argëtimi, loja, sporti etj (per kete Bashkia ka vene ne funksion te institucioneve arsimore qendren multifunksionale ne qytet)

Nxitja dhe promovimi i aktiviteteve kulturore , sportive dhe argetuese per femije.

Duke ju falenderuar .

DREJTORI

Arta Shaha